UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
REKTORATI
Pranuar me dt. 26.10.2026
Njësia organ. | Numër | Nr. Ekzem. | Vlera
259/13

UNIVERSITETI ISA BOLETINI MITROVICË
FAKULTETI JURIDIK
Pranuar me dt. 23.10.2026
Njësia organ. | Numër | Nr.Ekzemplarë | Vlera
366

UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Fakulteti Juridik

Këshillit të Fakultetit Juridik

Mendim i ndarë lidhur me vlerësimin e kandidatit Xhemajl Veliqi për pozitën e asistentit në Fakultetin Juridik, sipas konkursit nr. prot. 2193, të datës 23.09.2026

Të nderuar anëtarë të KFJ

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicës, me konkursin nr. prot. 2193, të datës 23.09.2026, ka shpallur një (1) pozitë të asistentit në Fakultetin Juridik për lëndët: "E drejta penale", "E drejta e procedurës penale (pjesa e përgjithshme)", "Kriminalistika", "Procedura penale e avansuar", "E drejta penale e avansuar", "Kriminologji me penologji", "Viktimologji", "Shkrimi akademik" dhe "Bazat e sistemit të drejtësisë".

Në cilësinë e anëtares së Komisionit Vlerësues, në mbështetje të nenit 16, paragrafëve 17, 23 dhe 25, të Rregullores nr. prot. 3013, të datës 21.12.2023, të cilët përcaktojnë detyrimet dhe përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues, si dhe detyrimin për paraqitjen e propozimit të ndarë në rast mospajtimi, paraqes këtë mendim të ndarë - negativ, për zgjedhjen e kandidatit Xhemajl Veliqi, për këto arsye:

1. Aktakuza ndaj kandidatit Xhemajl Veliqi dhe çështja e integritetit akademik e institucional.

Prokuroria Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP.I.nr.117/2023, të datës 20.09.2023, ka ngritur aktakuzë ndaj kandidatit Xhemajl Veliqi për dy vepra penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin e saj PN.nr.1665/2025, të datës 13.11.2025, ka vendosur vazhdimin e procedurës penale ndaj Xhemajl Veliqit.

Pretendimet që përbëjnë bazën e kësaj aktakuze, nëse vërtetohen, bien ndesh me standardet e integritetit akademik, profesional dhe institucional që kërkohen nga një kandidat për pozitën e asistentit në Fakultetin Juridik, veçanërisht në raport me nenin 19, paragrafi 1, si dhe nenet 9 dhe 11 të Kodit të Etikës së UIBM-së, nr. prot. 447, të datës 21.02.2023.

Duke respektuar prezumimin e pafajësisë dhe duke pasur parasysh se aktakuza nuk përbën pengesë automatike për zgjedhje, vlerësoj se këto rrethana kërkojnë shqyrtim institucional për të përcaktuar nëse kanë ndikim në përmbushjen e standardeve etike dhe profesionale të kërkuara për këtë pozitë.

2. Dyshimi për konflikt të mundshëm të interesit.

Arsyeja e dytë lidhet me faktin se Vilard Bytyqi, anëtar i Komisionit Vlerësues, është bashkautor i një punimi shkencor me kandidatin Xhemajl Veliqi.

Konkretisht, Vilard Bytyqi, Albert Zogaj dhe Xhemajl Veliqi janë bashkautorë të punimit "Combating Migrant Smuggling by Sea: Analysis of EU Action Plan Against Migrant Smuggling and Standards of Migrant Smuggling Protocol", të publikuar në revistën Transactions on Maritime Science, 2024.

Konsideroj se kjo marrëdhënie e bashkëpunimit shkencor kërkon shqyrtim në kuptim të nenit 166, paragrafi 7, të Statutit të UIBM-së, nenit 21 të Kodit të Etikës dhe Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Ndonëse bashkautorësia shkencore nuk përbën automatikisht konflikt interesi, vlerësoj se Këshilli i Fakultetit Juridik duhet të verifikojë nëse pjesëmarrja e njërit anëtar të komisionit në vlerësimin e kandidatit cenon ose mund të cenojë paanshmërinë dhe objektivitetin e procedurës.

PËRFUNDIM:

PROPOZIMI I NDARË - NEGATIV

Duke u mbështetur në rrethanat e paraqitura më lartë, si dhe në detyrimin e përcaktuar me nenin 16, paragrafi 23, të Rregullores nr. prot. 3013, paraqes këtë: Propozim të ndarë - negativ, përderisa nuk janë verifikuar dhe sqaruar rrethanat juridike, etike dhe procedurale të sipërpërmendura. Poashtu kërkoj që gjatë tërë procesit të përfshihet mendim im i ndarë.

Me respekt,

Prof. ass. dr. Arta Dauti

Anëtare e Komisionit Vlerësues

Fakulteti Juridik UIBM

23.10.2026, Mitrovicë